



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASENIT UJOR SEMAN

VENDIM

Nr.2, datë 08.11.2022

PËR
MIRATIMIN E LEJES “PËR KRYERJE SHPIMI NËNTOKËSOR
PËR NXJERRJE UJI (PUS-SHPIMI)”
SUBJEKTIT “LLAZO” SH.P.K

Në mbështetje të pikës 2, nenit 50, të ligjit nr.111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, të ndryshuar, vendimit nr.550, datë 15.7.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujqor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujqor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujqor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre”, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujqore, Këshilli i Basenit Ujqor Seman,

V E N D O S I:

1. Miratimin e lejes për kryerje shpimi nëntokësor për nxjerrje uji (pus-shpimi) për përdorim teknologjik (larja e produkteve të mishit si dhe mbajtja pastër e ambjenteve), subjektit “Llazo”sh.p.k, me vendndodhje Njësia Administrative Krutje Lushnje Qarku Fier.
2. Treguesit paraprak janë si më poshtë:

Vendndodhja e përcaktuar për pus-shpimin sipas KRGJSH

- X= 471793.2; Y= 4527325.5; Z= 6 m.m.n.d

Vendndodhja e përcaktuar për pikën e shfrytëzimit sipas KRGJSH

- X= 471793.2; Y= 4527325.5; Z= 6 m.m.n.d

- Prurja e kërkuar: $Q= 2.00$ l/sek

3. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas zbardhjes formalisht dhe njoftimit të subjektit të interesuar.

KRYETARI I KBU SEMAN

LEFTER SHEHAJ

